

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**– Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me sekretaren juridike Nushe Kadrija, në lëndën penale kundër të pandehurit Q. Th. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.1511/2016 të datës 18.10.2016, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 16.11.2016 merr këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I pandehuri:

**Q. TH.**, nga i ati R., e ëma S., e gjinisë P., i lindur me datën ..., në Gjakovë, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 09.09.2016, rreth orës 18:45 minuta, derisa po lëvizte në Gjakovë në rrugën “S.” me dije e përdor dokumentin e falsifikuar si origjinal, përkatësisht xhamat e errësuar në atë mënyrë që ditën kritike patrulla e policisë në Gjakovë, duke patrulluar kishin vërejtur se makina e llojit “A” me targa të regjistrimit “...”, të cilin e drejtonte pronari Q. Th. atëherë posedon xhama të errësuar (përves parafangos), gjithashtu gjatë kontrollimit të dokumentacionit vërtetohet se në librezën e automjetit ishte vendosur shënime shtesë si “Automjeti posedon xhama të errësuar nga prodhuesi”, po ashtu në automjet ishin të vendosura folje pa marrë certifikatën nga Qendra e Automjeteve të Kosovës, ashtu që të njëjtit i konfiskohet CRA, dhe i njëjti me urdhër të prokurorit e largon veturën nga komunikacioni.

Me çka ka kryer veprën penale: falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par. 1 të KPRK-së

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 495 të KPP-së, jep këtë:

### U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

**Pranohet** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP. nr. 1511/2016 të datës 18.10.2016.

Andaj, gjykata ne kuptim të nenit 4, 41, 43 par.1 pika 1.3, 46, 69 par.1, 73 të KPRK-së dhe nenit 398 par.1 të KPRK-së, të pandehurit ia shqipton:

### D Ë N I M I N M E G J O B Ë

Në shumë prej 400 (katërqind) Euro, të cilin dënim i pandehuri duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ta paguaj gjobën apo nuk mund ta paguaj shumën e mbetur të dënimit me gjobë, gjykata do ta zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg, në kohëzgjatje prej 20 ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 Euro.

Ndaj të pandehurit Q. Th. konform nenit 69 par.1 të KPRK-së, konfiskohet Certifikata e regjistrimit të automjetit (CRA) me numër ..., si mjet i kryerjes së veprës penale.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me numër PP.nr. 1511/2016 të datës 18.10.2016, kundër të pandehurit Q. Th. nga Gjakova, për shkak të veprës penale: falsifikim i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPRK-së, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimorë, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të pandehurit do ti shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i pandehuri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shikimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 të KPP-së, dhe në kuptim të nenit 495 par.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: nga, deklarata e të pandehurit të dhënë në stacion policor dhe në Gjakovë e datës 26.09.2016, raporti i oficerit dt. 09.09.2016, Corpus delicti, certifikata e regjistrimit të automjetit (CRA, deklarata e të pandehurit të dhënë në stacion policor në Gjakovë, 26.09.2016, foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera u vërtetua se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata iu shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i dënimit, që në të ardhmen i pandehuri të mos kryej ndonjë veprë penale të paraparë me ligj.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësorë është marrë konform nenit 450 par. 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP.

Me sa u tha me lartë, në kuptim të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**- Departamenti i përgjithshëm -**  
**P.nr.626/16, me datë 16.11.2016**

**Procesmbajtësja,**  
**Nushe Kadrija**

**Gjyqtari i vetëm gjyqës,**  
**Mentor Bajraktari**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën Themelore në Gjakovë. Nëse i pandehuri nuk parashtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.